



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“ELEKTROMEKANIKË”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

E4-III-22

Tiranë, 2022

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Elektromekanikë			Kodi E4-III-22
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin mësimor “Elektromekanikë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është “zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe të përgatisë punonjës të kualifikuar për instalimin, montimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektromekanike, apo për krijimin e një biznesi privat në këtë fushë.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në profilin mësimor “Elektromekanikë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Elektroteknikë” niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatitin udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin mësimor “Elektromekanikë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të nivelit, të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të cilat njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore të prodhimit, transmetimit, montimit dhe mirëmbajtjes të pajisjeve elektromekanike (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportierë, impiante ngrohje-ftohje etj.), në njësi të shitjes së pajisjeve elektromekanike, si dhe në veprimtari të tjera që ushtrohen në këtë drejtim. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në këtë fushë.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK (technik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	E-II-04-13, E4-III-19			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin mësimor “Elektromekanikë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Organizimi i punës dhe i vendit të punës

- Të përshkruajë rëndësinë e planifikimit të proceseve të punës;
- Të shpjegojë mënyrën dhe elementët e planifikimit të burimeve të nevojshme për proceset e punës (njerëzore, financiare, materiale etj.);
- Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në proceset e punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të punës;
- Të përshkruajë llojet e materialeve, karakteristikat kryesore sipas përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë llojet pajisjeve dhe mjeteve të punës, funksionin dhe përdorimin e tyre
- Të përshkruajë llojet e instrumenteve matës, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Të përshkruajë llojet e sinjalistikës së nevojshme sipas proceseve të punës;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e ruajtjes së dokumentacioneve;
- Të përshkruajë rëndësinë e plotësimit të një urdhri pune;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit, sistemimit dhe mirëmbajtjes së vendit të punës;
- Të listojë llojet e raportimeve në vendin e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të hierarkisë në vendin e punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores së brendshme të biznesit;

Bazat e sipërmarrjes

- Të shpjegojë sipërmarrjen dhe elementet e saj, si dhe lidhjen me veprimtarinë njerëzore;
- Të shpjegojë funksionet e sipërmarrjes dhe organizimit të punës në biznes;
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Të përshkruajë parimet bazë të kodit të punës;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave, institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojë konceptet bazë të legjislacionit dhe elementet përbërës të tij;
- Të përshkruajë llogaritjet e thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës dhe përdorimin e Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) në biznes;
- Të shpjegojë rëndësinë, mjetet, strategjinë, si dhe 4 elementet e marketingut: produkti, çmimi, promovimi dhe shpërndarja
- Të përshkruajë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të listojë llojet e kontratave në një biznes;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe nevojën e përdorimit të TIK për krijimin e kontakteve në biznes.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të kërkesave të sigurisë në punë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës, në montime, mirëmbajtje etj., si dhe masat mbrojtëse përkatëse;
- Të përshkruajë mjetet dhe pajisjet mbrojtëse, individuale dhe kolektive të punës;
- Të shpjegojë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik të mbrojtjes nga rryma elektrike;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik për garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike;
- Të përshkruajë rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të përshkruajë rregullat përkatëse gjatë përdorimit të materialeve të ndezshme dhe bombulave të gazit;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të impiantit të MNZSH;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit për raste të ndryshme emergjente;
- Të përshkruajë rregullat e organizimit të punës për sigurimin e cilësisë dhe parandalimin e aksidenteve;
- Të përshkruajë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në vendin e punës;
- Të shpjegojë nevojën e sistemimit dhe evakuimit të mbeturinave dhe produkteve të dëmshme, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;

Montimi i makinerive dhe pajisjeve të repartit

- Të analizojë planimetrinë e përgjithshme të repartit dhe pozicionimin e pajisjeve në të;
- Të shpjegojë rëndësinë e ballafaqimit të projektit me objektin;
- Të shpjegojë rëndësinë e leximit të manualeve dhe procedurave të montimit, skemave të thjeshta të rrjeteve elektrike, të mekanizmave, të sistemeve ndihmëse etj.;
- Të listojë pjesët përbërëse mekanike, elektrike dhe elektronike të një makinerie apo linje teknologjike, si dhe funksionet e tyre;
- Të listojë llojet e bazamenteve sipas tipit të makinerisë dhe pajisjeve përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së bazamenteve, sipas tipit të makinerisë dhe pajisjeve përkatëse;
- Të përshkruajë teknikat e pozicionimit dhe fiksimit të makinerisë dhe pajisjeve, sipas projektit të planvendosjes;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së rrugëve të kalimit të përcjellësve, kabllave elektrik në reparte;
- Të përshkruajë mënyrën e shtrimit të përcjellësve, kabllave elektrik në reparte;
- Të përshkruajë teknikat e montimit të sistemeve mekanike dhe sistemeve ndihmëse të thjeshta (ftohjes, lubrifikues, grasatues, pneumatik e tjerë);
- Të përshkruajë teknikat e montimit të paneleve të komandimit dhe të furnizimit të makinerive dhe pajisjeve;
- Të përshkruajë teknikat e montimit për ashensorët, shkallët lëvizëse, transportierët, impiantet e ngrohje-ftohjes;
- Të përshkruajë teknikat e montimit të transmisioneve elektromekanike, frena, xhunto etj.

Instalimet e makinerive dhe pajisjeve të repartit

- Të interpretojë dokumentacionin teknik, librat e makinerive, instruksionin e përdorimit dhe historikun e tyre;
- Të përshkruajë skemën teknologjike dhe analizën funksionale të: ushqyesve AC dhe DC, releve të ndryshme (mbrojtjes termike, shumë funksionesh, statike etj.);
- Të dallojë elementët e mbrojtjes sipas parametrave të tyre teknikë;
- Të dallojë tipat të ndryshëm të ndriçuesve duke përshkruar parimin e punës për secilin;
- Të listojë llojet të ndryshme sensorësh sipas përdorimeve;
- Të shpjegojë parimin e punës dhe fushën e aplikimit për sensorë të ndryshëm (të rrjedhjes, të lëvizjes, induktive, kapacitive, fotoelektrike, të shpejtësisë, të lagështirës, fundore, hidraulike, pneumatike etj.);
- Të përshkruajë teknikat e instalimit të makinerisë dhe pajisjeve, sipas projektit dhe manualit përkatës;
- Të përshkruajë mënyrën e instalimit të përcjellësve, kablove elektrik në makineritë dhe pajisjet;
- Të përshkruajë teknikat e instalimit të sistemeve mekanike, sistemeve ndihmëse të thjeshta (ftohjes, lubrifikues, grasatues, pneumatik e tjerë);
- Të përshkruajë teknikat e instalimit të paneleve të komandimit, të furnizimit etj. të makinerive dhe pajisjeve;
- Të përshkruajë teknikat e instalimit për ashensorët, shkallët lëvizëse, transportierët, impiantet e ngrohje-ftohjes;
- Të përshkruajë teknikat e instalimit të transmisioneve elektromekanike, frena, xhunto, etj.;
- Të përshkruajë teknikat e instalimit të sensorëve me pajisjet e kontrollit dhe pajisjet ekzekutuese;

Ndërtimi dhe funksionimi i transmisioneve elektromekanike

- Të shpjegojë furnizimin me energji elektrike dhe mbrojtjen e pajisjeve elektrike, makinerive, pajisjeve dhe sistemeve ndihmës;
- Të shpjegojë funksionin dhe pjesët përbërëse të transmisionit elektromekanik;
- Të përshkruajë mekanikën e transmisioneve elektrike (motor, xhunto, rripa, zinxhirë), freksionet dhe frenat me komandim elektrik, etj.;
- Të shpjegojë, mbi bazën e të dhënave të vizatimit, skema mekanike të thjeshta për adaptimin ose modifikimin e një nyjeje;
- Të shpjegojë llojet e kushinetave rrëshqitëse dhe rrokullisëse, përzgjedhjen e tyre, mënyrat e vendosjes (çiftëzimet në boshte dhe vrima), guarnicioneve, llojet dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë bashkimet me kiaveta, llojet e kiavetave, mënyrat e montimit të bashkimeve me kiaveta;
- Të shpjegojë bllokimin e dadove dhe vidave, fermot, llojet dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë transmisionet mekanike për makina dhe pajisje të ndryshme;
- Të përshkruajë procesin mekanik për montimin e elektromotorëve;
- Të analizojë mënyrat e lëshimit, rregullimit të shpejtësisë dhe frenimit të motorëve elektrikë;
- Të përshkruajë parimin fizik dhe funksional të friksioneve dhe frenave me anë të vënies nën tension dhe presion të sustave;
- Të shpjegojë rastet e mundshme të defekteve duke vlerësuar për diagnostikim, simptomat vizuale dhe zhurmat në rast defekti të friksioneve, frenave dhe të friksionit-fren;
- Të përshkruajë rëndësinë e hermeticitetit në xhuntot statike dhe kinetike dhe domosdoshmërinë në kushtet e tyre të punës;

- Të përshkruajë materialet dytësore hermetizuese në përdorim, vetitë e tyre, fusha e përdorimit dhe format e tregtimit;
- Të përshkruajë procesin mekanik për të zëvendësuar kushinetat e një boshti transmisioni;
- Të përshkruajë procesin mekanik të montimit dhe çmontimit të makinave, pajisjeve dhe sistemeve ndihmëse;
- Të shpjegojë elementet pneumatike dhe hidraulike të pajisjeve industriale:

Njohuri bazë mbi qarqet e komandimit dhe të kontrollit elektronik në transmissione elektromekanike

- Të tregojë rolin e burimeve të ushqimit në qarqet elektrike;
- Të shpjegojë funksionimin e portave të thjeshta logjike;
- Të shpjegojë parimin e punës së përforcuesve operacional;
- Të shpjegojë skemat e drejtuesit të valës;
- Të dallojë tipet e gjeneratorëve impulsivë dhe funksionimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes të sinjaleve të hyrjes dhe të daljes;
- Të përshkruajë mënyrën e rritjes ose zvogëlimit të rrymës në dalje të një ushqyesi;
- Të përshkruajë mënyrat dhe skemat e lëshimit dhe komandimit të elektromotorëve;
- Të përshkruajë parimin e punës së soft starterit dhe përdorimin e tij në industri;
- Të përshkruajë parimin e punës së inverterit dhe përdorimin e tij në industri;
- Të përshkruajë PLC hyrjet, daljet e saj, softin e programimit dhe disa skema të thjeshta logjike;

Matjet dhe aparatet matëse në elektromekanikë

- Të listojë aparatet matëse për matjet mekanike (matjet me kalibër, mikrometër, termometër dhe aparatet matëse të presionit etj.);
- Të përshkruajë metodat e matjeve elektrike, elektronike, mekanike dhe dallimet midis tyre;
- Të përshkruajë gabimet që shoqërojnë matjet elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të përshkruajë matjen e madhësive jo-elektrike me metoda elektrike;
- Të përshkruajë nocionin e izolimit dhe përdorimit të aparatit matës të izolacionit;
- Të shpjegojë pasojat e një izolacioni të dobët;
- Të përshkruajë mënyrën e matjes së tokëzimit dhe të përdorimit të aparatit për matjen e tij;
- Të shpjegojë fenomenin e ngrohjes në makinat elektrike dhe humbjet në to;

Mirëmbajtje dhe riparime elektromekanike

- Të përshkruajë rëndësinë e leximit të manualeve të mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e kryerjes së kontrollit periodik të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut;
- Të përshkruajë rëndësinë e kryerjes së shtrëngimeve të mundshme dhe periodike të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut;
- Të përshkruajë teknikat e grasatimeve dhe lubrifikime të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut dhe me materialet e duhura;
- Të përshkruajë teknikat e kontrolleve dhe matjeve të impiantit të tokëzimit sipas standardeve përkatëse;
- Të analizojë përshkruajë tipet e alarmeve në makineri dhe pajisje;

- Të listojë defektet, mënyrën e diagnostikimit dhe riparimin e mekanizmave të transmetimit të lëvizjeve (motor, xhunto, rripa, zinxhirë), freksionet dhe frenat me komandim elektrik;
- Të përshkruajë rëndësinë e kryerjes së testeve periodike të sistemeve të alarmit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e mirëmbajtjes së paneleve të furnizimit elektrik dhe komandimit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e mirëmbajtjes së sistemeve të ndriçimit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e mirëmbajtjes së ashensorëve, shkallëve lëvizëse, transportierëve, pajisjeve të kondicionimit, etj.;
- Të përshkruajë përdorimin e llojeve të ndryshme të mjeteve ngritëse dhe mbajtëse manuale (leva, kapëse, ganxa, parango);
- Të përshkruajë përzgjedhjen e kavove dhe litarëve mbajtës, në funksion të ngarkesës, peshës, temperaturës, etj.;
- Të përshkruajë rregullat e transportimit mbi rrula të makinave dhe pajisjeve të rënda;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe mënyrat e përdorimit të elementeve të pastrimit, vajojës dhe grasatimit;
- Të përshkruajë mënyrën dhe rastet e përdorimit të mjeteve të çmontimit/montimit;
- Të shpjegojë ndryshimin e gjendjes së sipërfaqeve nga konsumimi, gripimi, gërryerja, nxehja, etj.;
- Të përshkruajë mënyrat dhe mjetet që duhen për të realizuar riparimin e paketave elektronike.

Testimi dhe kontrolli teknik i pajisjeve, makinerive dhe rrjetit

- Të shpjegojë llojet e defekteve dhe rëndësinë e riparimit të makinave;
- Të shpjegojë konsumimin e detaleve, llojet e tij, faktorët që ndikojnë në konsumimin e detaleve dhe rrugët për rritjen e kohës së shërbimit, si dhe konsumin e lejuar në disa detale tipike;
- Të shpjegojë mënyrën e testimit të makinerive dhe pajisjeve;
- Të shpjegojë mënyrat e testimit pas riparimit të pajisjeve elektromekanike dhe mekanike;
- Të shpjegojë kontrollet teknike periodike për pajisjet mekanike dhe elektromekanike;

Materialet në sistemet elektromekanike

- Të përshkruajë llojet e ndryshme të materialeve elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të materialeve metalikë dhe lidhjeve metalike që përdoren në makinat, pajisjet dhe sistemet ndihmëse në elektromekanikë;
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të lëndëve plastike në përdorim në elektromekanikë, karakteristikat e tyre dhe format e tregtimit;
- Të përshkruajë llojet kryesore të ngjitësve mekanikë dhe avantazhet e bashkimit me ngjitje;
- Të shpjegojë nocionet bazë mbi saldimit dhe ngjitjen me kallaj;
- Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së buzëve në funksion të procesit të saldimit dhe të trashësisë së fletëve;
- Të shpjegojë aplikimin e parimeve të përgjithshme të lubrifikimit;
- Të përshkruajë rolin e përgjithshëm të lubrifikantëve dhe ndarjen sipas kategorive dhe fushës (vajra, graso, lubrifikante të ngurtë dhe sintetike);

Komunikimi etik dhe profesional

- Të përshkruajë rëndësinë e komunikimit dhe teknikat përkatëse;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të Kodit të etikës;

- Të përshkruajë parimet dhe teknikat e punës në grup;
- Të listojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Elektromekanikë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë aftësitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Organizimi i punës dhe i vendit të punës

- Të planifikojë proceset e punës në mjediset teknike;
- Të planifikojë burimet e nevojshme për një proces pune të dhënë (njerëzore, financiare, materiale etj.);
- Të vendosë prioritetet në proceset e punës;
- Të organizojë punën dhe vendin e punës për realizimin e detyrës;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve sipas karakteristikave dhe përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e pajisjeve dhe mjeteve të punës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë llojet e instrumenteve matës sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të përzgjedhë llojet e sinjalistikës së nevojshme sipas proceseve të punës;
- Të plotësojë, sipas formave dhe mënyrave të përcaktuara, dokumentacionet e nevojshme;
- Të arkivojë, sipas rregulloreve përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm;
- Të plotësojë urdhrin e punës për realizimin e detyrës së dhënë;
- Të kryejë pastrimin, sistemimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, mjeteve dhe vendit të punës;
- Të raportojë për punën e kryer sipas hierarkisë;
- Të respektojë hierarkinë në vendin e punës;
- Të zbatojë rregulloret e brendshme të biznesit;

Bazat e sipërmarrjes

- Të krijojë një plan të thjeshtë biznesi në fushën e elektromekanikës;
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Të bashkëveprojë me bankat dhe institucionet financiare;
- Të zbatojë kërkesat e legjislacionit fiskal dhe atij të punës;
- Të kryejë llogaritjet të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të kryejë planifikimet e burimeve të nevojshme për proceset e punës (njerëzore, financiare, materiale, etj.);

- Të zbatojë strategji të marketingut për biznesin e vet;
- Të llogarisë materialet dhe kohën e punës bazuar në një projekt të dhënë;
- Të kryejë llogaritje të kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përgatisë një ofertë për shërbimin që do të kryejë;
- Të plotësojë faturat për shërbimin e kryer;
- Të respektojë kontratat dhe kushtet e realizimit të tyre;
- Të paraqesë kërkesë për furnizimin me energji elektrike në institucionin përkatës;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të respektojë kërkesa të sigurisë në punë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Të përzgjedhë dhe përdorë mjetet dhe pajisjet mbrojtëse, individuale dhe kolektive të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës dhe masat mbrojtëse përkatëse;
- Të zbatojë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik të mbrojtjes nga rryma elektrike;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik për garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike;
- Të zbatojë rregullat përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike të rrezikshme;
- Të zbatojë rregullat përkatëse gjatë përdorimit të materialeve të ndezshme dhe bombulave të gazit;
- Të përdorë impiantin e MNZSH;
- Të zbatojë procedurat e evakuimit për raste të ndryshme emergjente;
- Të zbatojë rregullat e organizimit të punës për parandalimin e aksidenteve;
- Të japë ndihmën e parë në vendin e punës, në rast aksidenti;
- Të kryejë sistemimin dhe evakuimin e mbeturinave dhe produkteve të dëmshme, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e mjedisit;

Montimi i makinerive dhe pajisjeve të repartit

- Të kryejë ballafaqimin e projekti me objektin;
- Të lexojë manualat dhe procedurat e montimit, skemat elektrike, të mekanizmave dhe të sistemeve ndihmëse;
- Të dallojë pjesët përbërëse mekanike, elektrike dhe elektronike sipas përdorimit të tyre;
- Të bashkëpunojë në ndërtimin e bazamenteve sipas tipit të makinerisë dhe pajisjeve përkatëse;
- Të zbatojë teknikat e pozicionimit dhe fiksimit të makinerisë dhe pajisjeve sipas projektit të planvendosjes;
- Të kontrollojë përgatitjen e rrugëve të kalimit të përcjellësve dhe kabllave elektrik në reparte;
- Të zbatojë teknikat e shtrimit të përcjellësve, kabllave elektrik në reparte;
- Të montojë sisteme mekanike dhe sisteme ndihmëse të thjeshta;
- Të montojë panelet e komandimit dhe të furnizimit të makinerive dhe pajisjeve;
- Të montojë ashensorët, shkallët lëvizëse, transportierët, impiantet e ngrohje-ftohjes;
- Të montojë transmisionet elektromekanike;

Instalimet e makinerive dhe pajisjeve të repartit

- Të mirëmbajë dokumentacionin teknik, librat e makinerive, instruksionin e përdorimit dhe historikun e tyre;
- Të instalojë, sipas skemës teknologjike, parimit të punës dhe funksionit: ushqyesit AC dhe DC, rele të ndryshme etj.;
- Të përzgjedhë elementët e mbrojtjes sipas parametrave të tyre teknikë të përcaktuara në projekt;

- Të përzgjedhë tipat të ndryshëm të ndriçuesve, në përshtatje me kërkesat për ndriçim të procesit teknologjik të përcaktuara në projekt;
- Të përzgjedhë, sipas parimit të punës dhe fushës së aplikimit të tyre, sensorët e ndryshëm (të rrjedhjes, të lëvizjes, induktive, kapacitive, fotoelektrike, të shpejtësisë, të lagështirës, fundore, hidraulike dhe pneumatike) sipas nevojave të procesit teknologjik;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të makinerisë dhe pajisjeve sipas projektit;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të përcjellësve, kabllave elektrik në makineritë dhe pajisjet;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të sistemeve mekanike dhe sistemeve ndihmëse të thjeshta (ftohjes, lubrifikues, grasatues, pneumatik e tjerë);
- Të zbatojë teknikat e instalimit të paneleve të komandimit dhe të furnizimit të makinerive dhe pajisjeve;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të transmisioneve elektromekanike, frena, xhunto etj.;
- Të zbatojë teknikat e instalimit për ashensorët, shkallët lëvizëse, transportierët, impiantet e ngrohje-ftohjes;
- Të zbatojë teknikat e instalimit të sensorëve me pajisjet e kontrollit dhe pajisjet ekzekutuese;

Mirëmbajtje dhe riparime elektromekanike

- Të zbatojë procedurat e përcaktuara në manualet përkatëse për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinerive dhe pajisjeve;
- Të kryejë kontrollin periodik të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut;
- Të kryejë shtrëngime të mundshme dhe periodike të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut;
- Të kryejë grasatime dhe lubrifikime të makinerive dhe pajisjeve sipas grafikut, duke përdorur materialet e duhura;
- Të kryejë kontrolle dhe matje të impiantit të tokëzimit sipas standardeve përkatëse;
- Të identifikojë alarmet në makineri dhe pajisje dhe kryejë manovrimet e nevojshme, sipas llojit të alarmit;
- Të kryejë testime periodike të sistemeve të alarmit;
- Të mirëmbajë panelet e furnizimit elektrik dhe komandimit;
- Të mirëmbajë sistemet e ndriçimit;
- Të mirëmbajë ashensorët, shkallët lëvizëse, transportierët, impiantet e ngrohje-ftohjes etj.;
- Të përdorë lloje të ndryshme të mjeteve ngritëse dhe mbajtëse (leva, kapëse, ganxha, parango etj.);
- Të përzgjedhë kavot dhe litarët mbajtës, në funksion të ngarkesës, peshës, temperaturës etj.;
- Të zbatojë rregullat e transportimit mbi rrula të makinave dhe pajisjeve të rënda;
- Të përzgjedhë elementet e pastrimit, vajosjes dhe grasatimit;
- Të përzgjedhë mjetet, pajisjet, aparatet e duhura të çmontimit dhe montimit;
- Të dallojë gjendjet e sipërfaqeve nga konsumimi, gripimi, gërryerja, nxehja etj.;
- Të përzgjedhë mënyrat dhe mjetet që duhen për të realizuar riparimin e paketave elektronike;
- Të dokumentojë mirëmbajtjet dhe riparimet e kryera;

Ndërtimi dhe funksionimi i transmisioneve elektromekanike

- Të sigurojë furnizimin me energji elektrike dhe mbrojtjen e pajisjeve elektrike, makinerive, pajisjeve dhe sistemeve ndihmës;
- Të vizatojë, mbi bazën e të dhënave, skema mekanike të thjeshta për përshtatje ose modifikime;

- Të përzgjedhë kushinetat rrëshqitëse apo rrokullisëse;
- Të zbatojë teknikat e vendosjes së kushinetave, guarnicioneve etj.;
- Të kryejë bashkime me kiaveta;
- Të kryejë bllokimin e dadove dhe vidave, fermot, sipas përdorimit të tyre;
- Të përcaktojë elementët e procesit mekanik për montimin e elektromotorëve;
- Të kryejë lëshimin, rregullimin e shpejtësisë dhe frenimin e motorëve elektrikë;
- Të kontrollojë dhe stabilizojë funksionimin e friksioneve dhe frenave me anë të vënies nën tension dhe presion të sustave;
- Të sigurojë hermeticitetin në xhuntot statike dhe kinetike;
- Të përzgjedhë materialet dytësore hermetizuese në përdorim;
- Të përzgjedhë elementet pneumatike dhe hidraulike të pajisjeve industriale;

Qarqet e komandimit dhe të kontrollit elektronik në transmisione elektromekanike

- Të përzgjedhë burimet e ushqimit në qarqet elektrike;
- Të përzgjedhë qarqe të integruara, përforcuesit operacional, sipas parimit të punës;
- Të përzgjedhë tipet e gjeneratorëve impulsivë sipas funksionimit të tyre;
- Të zbatojë teknikat e matjes të sinjaleve të hyrjes dhe të daljes;
- Të realizojë ndryshimin e rrymës në dalje të një ushqyesi;
- Të kryejë lëshimin e elektromotorëve sipas skemës përkatës;
- Të realizojë lëshimin e elektromotorëve, sipas skemës përkatës me soft starterit, inverterit dhe PLC;

Matjet dhe aparatet matëse në elektromekanikë

- Të përzgjedhë aparatet për matjet mekanike (matjet me kalibër, mikrometër, termometrat, aparatet matëse të presionit, etj.),
- Të përzgjedhë aparatet për matjet elektrike dhe elektronike;
- Të vlerësojë gabimet që shoqërojnë matjet elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të kryejë matjen e madhësive jo-elektrike me metoda elektrike;
- Të përdorë aparatet matës të izolacionit;
- Të kryejë matjet e tokëzimit duke përdorur aparatet dhe teknika përkatëse ;

Testimi dhe kontrolli teknik i pajisjeve, makinerive dhe rrjetit

- Të testojë funksionimin e makinerive dhe pajisjeve;
- Të identifikojë llojet e defekteve të makinave;
- Të kontrollojë konsumimin e detaleve duke e krahasuar me parametrat e prodhimit;
- Të testojë pajisjet elektromekanike dhe mekanike pas riparimit të tyre;
- Të kryejë kontrollet teknike periodike për pajisjet mekanike dhe elektromekanike;
- Të dokumentojë testimet dhe kontrollet e kryera;

Materialet në sistemet elektromekanike

- Të përzgjedhë llojet e ndryshme të materialeve elektrike, elektronike dhe mekanike;
- Të përzgjedhë llojet e ndryshme të materialeve metalikë dhe lidhjeve metalike që përdoren në makinat, pajisjet dhe sistemet ndihmëse në elektromekanikë,

- Të përzgjedhë llojet e ndryshme të lëndëve plastike në përdorim në elektromekanikë, karakteristikave të tyre dhe format e tregtimit;
- Të përzgjedhë llojet kryesore të materialeve ngjithës mekanikë;
- Të kryejë përgatitjen e buzëve në funksion të procesit të saldimit dhe të trashësisë së fletëve;
- Të kryejë saldime të thjeshta mekanike dhe elektrike;
- Të përzgjedhë llojet e ndryshme të lubrifikantëve sipas kategorive dhe fushës (vajra, graso, lubrifikante të ngurtë dhe sintetike);

Komunikimi në mënyrë etike

- Të zbatojë rregullat e komunikimit etik dhe profesional duke përdorur teknikat përkatëse;
- Të zbatojë kodin e etikës në veprimtarinë e vet;
- Të punojë në grup duke zbatuar teknikat dhe parimet përkatëse;
- Të zbatojë teknikat e zgjidhjes së problemeve;
- Të zbatojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të përdorë TIK në komunikim;
- Të përdorë terminologjinë profesionale gjatë komunikimit në veprimtarinë e vet;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.